

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Droni rus godet trenin pranë kufirit polak, pak minuta pas kalimit të ish-kryeministrit Boris Johnson
ADRESA	https://tpz.al/droni-rus-godet-trenin-prane-kufirit-polak-pak-minuta-pas-kalimit-te-boris-johnsonit-i332843
BURIMI	tpz.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	13 shtator 2026, 18:52:17 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	13 shtator 2026, 17:56:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	ce9fbf5822c1dcde0081099d260865591d41faa73a74d7fc54fd935559944aac
TEKSTI	55c44c55637008e137cec85457407809b058d9e098f018f18611b1c9d426a21
PAMJA	04fdc0a48fdf3ac6bc474c7b8ad49a6389a23663472c9885d993965b9535002b

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	224d32c5ddcb6dcb03b663a51e801524e52f53a75bcd4bb11a71a8d6b02e9bf6
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	189cdded276785f170fe9cc7ce5e87625aab0e70d3bc68c5e8e7b4173c15ebbc
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/224d32c5ddcb6dcb03b663a51e801524e52f53a75bcd4bb11a71a8d6b02e9bf6>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

FLASH!

18:08 PDK e konsideron Kuvendin të pakonstituuar dhe Qeverinë jokushtetuese: Do t'i drejtohem Gjykatës Kushtetuese • 15:54 Zgjidhet qeveria e re e Kosovës, Albin Kurti p

BOTA, 13 SEPTEMBER 2026, 19:56

Droni rus godet trenin pranë kufirit polak, pak minuta pas kalimit të ish-kryeministrit Boris Johnson

tpz.al TPZ



Ish-kryeministri britanik Boris Johnson është përfshirë në një incident sigurie në Ukrainë, pasi një tren pas atij me të cilin po udhëtonte drejt Polonisë u godit nga një dron rus pranë kufirit.

Boris Johnson po udhëtonte me një tren nate nga Kievi drejt Polonisë, kur në rajonin kufitar u raportuan sulme me dronë rusë, duke shkaktuar një alarm sigurie në trenin ku ndodhej ish-kryeministri britanik.

Sipas gazetës gjermane Der Spiegel, rreth orës 05:00 të mëngjesit të së dielës, treni me Johnson në bord ndaloj pranë kufirit polak, ndërsa pasagjerët morën një paralajmërim për evakuim.

Alarmi u hoq më vonë, pasi nuk u zbuluan dronë të tjerë në zonë, transmeton Telegrafi.

Megjithatë, situata ishte veçanërisht shqetësuese pasi treni i pasagjerëve që udhëtonte pas trenit të Johnsonit raportohet se u godit nga një dron, më pak se tre kilometra larg kufirit me Poloninë. Nuk pati viktima apo të plagosur.

Johnson raportohet se udhëtonte në të njëjtin tren me ish-kryeministrin suedez Carl Bildt, si dhe me Gunter Sautter, një nga këshilltarët më të afërt të kancelarit gjerman Friedrich Merz.

Sipas Der Spiegel, Sautter kishte qenë në Kyiv së bashku me këshilltarë të sigurisë nga Britania e Madhe, Franca dhe Italia, ku kishin zhvilluar bisedime me qeverinë ukrainase lidhur me mundësinë e negociatave të paqes me Rusinë.

Gazeta gjermane raportoi se linja hekurudhore mes Kyivit dhe Varshavës ishte sulmuar dhe një prej trenave ishte goditur.

Operatori ukrainas i hekurudhave, Ukrzaliznytsia, deklaroi se është e mundur që objektivi i dronit rus të ketë qenë një tren diplomatik.

Sipas kompanisë, treni diplomatik ishte nisur nga stacioni më herët se zakonisht, pasi oraret ishin ndryshuar në kohë reale për shkak të kërcënimit të vazhdueshëm nga sulmet ruse.

ide!

John Goci konkurron Donald Trump, sa do të shkojë ankandi?

Nga Thoma Gëllçi

"Liria punon", por duhen edhe 6 milionë dollarë!

Nga Mero Baze

Tej e Këtej



Tronditet Edi Rama, i kërkohet largimi urgjent nga zyra brenda shtatë ditëve (letra)

Denonco!

Ke një lajm që do ta ndash me redaksinë e TPZ? Na shkruaj në Messenger ose [kliko këtu](#) për mënyra të tjera kontakti.



Moti

Tirana, Albania

WebTV



Ka frikë nga hetimet guvernatori? Ola Xama tregon pse i duhet super imuniteti Gent Sejkos

[Shiko të tjera video](#)

Pas incidentit, Boris Johnson e dënoi sulmin, duke e cilësuar atë si "të rastësishëm dhe të pakuptimtë".

"Nuk e di se çfarë logjike të shtrembëruar e shtyu Putinin të shkatërronte një lokomotivë ukrainase të ndalur në kufirin polak këtë mëngjes", shkroi Johnson në rrjetin social X.

"Por ajo që mund të themi me siguri është se ky është lloji i sulmit të rastësishëm dhe të pakuptimtë që ukrainasit përballojnë çdo ditë – madje edhe në hekurudhat civile", shtoi ai.

Johnson tha gjithashtu se, sipas tij, sulmet ruse kanë shkaktuar vdekjen e 1,700 punonjësve të hekurudhave ukrainase.

"Ata dhe pasagjerët e tyre të përditshëm janë absolutisht heronj", deklaroi ish-kryeministri britanik.

Edhe Carl Bildt publikoi në X një video ku shfaqej evakuimi i një treni pas asaj që dukej si një shpërthim.

"Ky nuk ishte treni ynë, por ai që ishte vetëm disa minuta pas nesh pranë pikës kufitare", shkroi Bildt.

Ai tha se treni ishte evakuuar ndërsa droni rus po afrohej dhe se askush nuk ishte lënduar.

"Një sistem shumë i mirë sigurie. Treni ynë mori vetëm një paralajmërim për evakuim, por munda të vazhdonte drejt Dorohuskut. Sulmet ruse ndaj Ukrainës po intensifikohen", deklaroi Bildt.

Incidenti hekurudhor ndodhi në një kohë kur edhe një kamion, më pak se 1.6 kilometra larg kufirit të Ukrainës me Poloninë, u godit të dielën.

Rojet kufitare ukrainase thanë se operacionet në pikën kufitare Dorohusk-Yahodyn u ndërpre në përkohësisht pas incidentit.

Ministria ruse e Mbrojtjes deklaroi se objektivi i sulmeve ishte infrastruktura që përdoret për transportin e ngarkesave ushtarake nga Evropa drejt Ukrainës.

Ndërkohë, ndërsa vija e frontit ka mbetur kryesisht statike, Moska dhe Kyiv kanë intensifikuar sulmet me rreze të gjatë në javët e fundit, në përpjekje për të ndryshuar dinamikën e luftës.

BOTA / 13 September 2026, 18:54

Austria ndalon shaminë për vajzat nën 14 vjeç, shpërthen debati për lirinë fetare

BOTA / 13 September 2026, 18:53

Trump akuzon Zelenskyn për sulmet ndaj depove ruse të karburantit: Po e dëmton botën, ndiq qëllimet e tua, jo naftën

BOTA / 13 September 2026, 18:06

**27-vjeçarja hidhet nga kati i
15-të i pallatit, bie sipër
karrocës me fëmijë**

BOTA / 13 September 2026, 15:56

**Kremlini: Bisedimet
trepalëshe SHBA-Rusi-
Ukrainë mund të zhvillohen
në tetor**

BOTA / 13 September 2026, 14:58

**Turqia nis operacion kundër
organizatave LGBTQ+,
arreston dhjetëra persona**

BOTA / 13 September 2026, 13:42

**Trump zhgënjën Arabinë
Saudite, Princi Bin Salman i
telefonoi dy herë, por SHBA
refuzoi të qëllonte rebelët
Houthi**

BOTA / 13 September 2026, 13:41

**Tri humbje dhe më afër fitores
se kurrë, 2027-a mund të jetë
viti i Marine Le Pen**

BOTA / 13 September 2026, 13:39

**Goditet një pikë karburanti
pranë kufirit me Poloninë,
ministri ukrainas: Terrori i
Putinit po troket në dyert e BE
dhe NATO-s**

BOTA / 13 September 2026, 12:43

**A mund t'i mbijetojë tregu i
naftës një lufte të përhjetshme
me Iranin?**

BOTA / 13 September 2026, 11:00

**Një 21-vjeçar nga India hoqi
mbeturinat nga lumi, merr
ofertë pune nga Holanda**

BOTA / 13 September 2026, 10:30

"Nëse do bisedime eja në Moskë", Lavrov i përgjigjet Zelenskyt: Nuk na mungon vullneti, por atij i mungon karakteri

BOTA / 13 September 2026, 10:29

"IA mund të bëhet e rrezikshme nëse nuk menaxhohet siç duhet", Obama ngre alarmin: S'duhet të kontrollohet nga duar private

BOTA / 12 September 2026, 20:58

Kina kërcënon me anulimin e samitit Xi-Trump nëse SHBA miraton shitje të reja armësh për Tajvanin

BOTA / 12 September 2026, 20:47

Mbijetoi tri ditë mbi varkën e përmbysur në Detin Bering, 15-vjeçari shpëtohet pasi humbi vëllain dhe kushëririn

BOTA / 12 September 2026, 20:29

Gjermania në protesta kundër AfD-së, rreth 150 mijë njerëz në rrugë pas fitores së ekstremit të djathtë

BOTA / 12 September 2026, 20:11

Samiti i BRICS-it, mesazh për Lindjen e Mesme: Dialog dhe paqe

BOTA / 12 September 2026, 19:42

Kremlini i përgjigjet Zelenski-t: Nëse do takim me Putinin mund të vish në Moskë

BOTA / 12 September 2026, 18:38

"Jam gati të takohem me Putin në Samitin e G20 në SHBA"- Zelensky: Duhet të flasim dhe të vendosim!

BOTA / 12 September 2026, 17:38

**Trafik droge përmes pakove
postare, goditet banda
kriminale në Valencia/
Arrestohen 5 persona**

BOTA / 12 September 2026, 16:53

**Hijet e Balikesirit në Turqi:
Historia e Tulutabakëve,
rezistenca kundër ushtarëve
grekë gjatë Luftës për
Pavarësi**

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.